Në bazë të Nenit 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 055/16,074/16,02/18,066/19,140/22), Nenit 28 paragrafi 7 të Statutit të DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz, në propozim të u.d Drejtorit ekzekutiv, Bordi i drejtorëve në mbledhje të rregullt, më 16.12.2022 aprovon:

PROGRAMIN E PUNËS ME PLANIN FINANCIAR TË DOO "VODOVOD I KANALIZACIJA TUZI / SH.P.K UJËSJIELLËSI DHE KANALIZIMI" TUZ PËR VITIN 2024

1. HYRJE

DOO "Vodovod i kanalizacija Tuzi / SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi Tuz, si subjekt juridik, është organizuar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Tuzit, nr.02-030/21-14526, datë 24.11.2021. ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale") 040/21 datë 03.12.2021., në përputhje me Ligjin për Shoqëritë afariste, Ligjin për Shërbimet Komunale dhe Statutin e Shoqërisë.

Baza ligjore për miratimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë është përcaktuar me dispozitat e nenit 26, paragrafi 1 dhe nenit 29, paragrafi 2, pikës 7 të Ligjit për Shërbimet Komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" numër 55/16. 074/16, 002/18 dhe 066/19), të Rregullores për përmbajtjen e detajuar të programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale dhe raportin vjetor për zbatimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" nr. 54/20), nenit 3 të Vendimit për Rendin komunal të komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale" nr. 038/20) dhe nenit 9 të Marrëveshjes për besimin dhe kryerjen e veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale dhe aseteve tjera në pronësi të komunës së Tuzit, nr.01-178, datë 14.01.2019.

DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz, e hartoi këtë Program pune me qëllim të përcaktimit të udhëzimeve të qarta për zhvillimin e Shoqërisë, i cili përfshin qëllimet dhe aktivitetet strategjike që planifikohen të zbatohen në mënyrë që të bëhen shembull i një Shoqërie të suksesshme që ofron shërbime komunale në përputhje me legjislacionin aktual, me standardet më të larta të cilësisë.

Aspektet e përgjithshme dhe koha në të cilën përpilohet Plani i punës për vitin 2024 janë shumë komplekse dhe të paparashikueshme, në kushtet e shpejtësisë së ndryshimeve dhe lëvizjeve në tregun e mallrave, punimeve dhe shërbimeve, me ç'gjë është i kushtëzuar edhe përpilimi i mikro dhe makro planeve në periudhë më të shkurtër apo më të gjatë kohore.

Qëllimi i përpilimit të Planit është që në mënyrë sistimore të përcaktohen aktivitetet për vitin e ardhshëm dhe ato aktivitete t'u jepen personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve të planifikuara në kornizën e definuar kohore. Esenca e të planifikuarit strategjik është në dallimin e rasteve të pritura dhe kërcënimeve nga mjedisi i jashtëm, të cilat mund të ndodhin në të ardhmen dhe të cilat vendosen në marrëdhënie me fuqitë dhe dobësitë e mjedisit, e të cilat gjatë periudhës së planifikuar duhet të zhvillohen që të mund të shfrytëzohen rastet e të evitohen kërcënimet, si dhe dobësitë e veta. Ky është proces që paraqet udhërrëfyes për ndryshime, e i cili duhet të prodhojë rezultate të dëshiruara financiare si pasojë e atyre ndryshimeve.

Në periudhën e ardhshme të planifikuar Shoqëria do të vazhdojë të punojë në mirëmbajtjen vijuese të rrjetit të ujësjiellësit dhe kanalizimit dhe si qëllim kryesor do të ketë furnizimin e rregullt të banorëve me ujë të pijshëm në trevën e komunës së Tuzit. Në lëminë e mirëmbajtjes investuese të sistemit të furnizimit me ujë, planifikohet metoda e kombinuar, gjegjësisht që kryerjen e punëve të vëllimit më të vogël t'ua besojmë të punësuarve në

Shoqëri, derisa për punët të cilat Shoqëria nuk mund t'i kryejë vetëm për shkak të vëllimit ose kompleksitetit të punës planifikohet angazhimi i kompanive tjera.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara të përshkruara, supozimi është që të shfrytëzohen maksimalisht të gjitha resurset ekzistuese, si dhe rritja e efikasitetit të punës të punësuarve përmes organizimit të punës në kompani dhe me përgjegjësi ndaj obligimeve të marra.

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara është përgatitur dhe është aprovuar Rregullorja dhe programi i masave nga fusha e mbrojtjes në punë (MNP), kurse kryerja e detyrave është planifikuar me dinamikë mujore.

Në kuadër të masave stabilizuese të cilat ka për qëllim t'i zbatojë Administrata e Shoqërisë gjatë periudhës planifikuese është inkuadrimi i kontrollit në prokurimet publike, si dhe përcjellja institucionale e realizimit të Kontratave të lidhura përmes zgjidhjeve aplikative të sistemit afaristo-informatik dhe me përgatitjen e Rregullores së re mbi punën, ku pjesë përbërëse është edhe sistematizimi dhe organizimi i brendshëm i Shoqërisë. Ky Program i punës është i përgatitur në pajtim me metodologjinë përkatëse të planifikimit, e në bazë të dhënave të mbledhura nga të gjitha pjesët organizative të Shoqërisë.

Prandaj, Plani i Punës në masë të madhe përcaktohet nga aktivitetet, të cilat në fakt janë një pasqyrë sintetike e analizave të deritanishme në veprimtarinë së Shpëqërisë dhe strategjisë së ardhshme zhvillimore të DOO "Vodovod i kanalizacija Tuzi /SH.P.K Ujësjetllësi dhe kanalizimi Tuz".

1.01 TË DHËNAT THEMELORE STATUSORE TË SHOQËRISË

Emërtimi zyrtar është:	Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar DOO "Vodovod i kanalizacija Tuzi /SH.P.K Ujësjetllësi dhe kanalizimi" Tuz;
Shkurtesa e emrit të shoqërisë:	DOO"Vodovod i kanalizacija/ SH.P.K Ujësjetllësi dhe kanalizimi" Tuz;
Statusi juridik:	Aktiv
Forma e organizimit:	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar;
Themelues:	Shoqëria është themeluar si njëantarrëshe ndërsa themelues është Kuvendi i Komunës së Tuzit.
Selia:	Tuz, Rruga 12. Nr. 48;
Aktiviteti kryesor:	36.00 Grumbullimi, pasterizimi dhe distribuimi i uji; 37.00 Menaxhimi i ujërave të zeza;
Numri amëz	33/31-00169-3
NIT:	03399702

Llogari transakcioni	520-44497-56
Organi mbikëqyrës i vetëqeverisjes lokale:	Sekretariati për zhvillimin e projekteve
Bordi i drejtorëve:	Anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë emëruar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Tuzit, me numër: 02-030/21-14526, datë 24.12.2021. (“Fleta Zyrtare Malit të Zi - dispozitat komunale” nr. 040/21, datë 03.12.2021. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë emëruar për një mandat katërvjeçar, duke filluar nga 24 dhjetori i vitit 2021 deri më 20 korrik 2023.
	1. Fatmir Beqiraj, kryetar 2. Almira Shabotiq, anëtare 3. Tonino Junçaj, anëtar 4. Prela Pllumaj, anëtar 5. Sulejman Beqaj, anëtar
Drejtor:	Ilir Camaj, ud Drejtor i Shoqërisë, emëruar më 07.06.2023. – në seancën e Bordit të drejtorëve të Shoqërisë.
Të dhënat e regjistrimit të parë:	Br.5-1000519/002, 23.09.2021.god.
Eadresa elektronike:	info@vutz.me
Web adresa:	www.vutz.me
Telefoni:	020/325-013

1.2. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË – MISIONI, VIZIONI DHE STRATEGJIA E SHOQËRISË

Misioni

Me njohuritë dhe veprimtarinë e vetë DOO “Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, ka obligim t’u sigurojë të gjithë konsumatorëve, furnizim publik të sigurtë dhe cilësor me ujë dhe kullim të ujërave të zeza me qëllimin e përhershëm të ruajtjes së ambientit dhe shëndetit të konsumatorit. Jemi të orientuar në rritjen e besueshmërisë në ofrimin e shërbimeve tona, zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe përmes kësaj të orientuar në dhënien e kontributit për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, si dhe fleksibilitetin dhe transparencën në komunikim me të tjerët, para së gjithash me shfrytëzuesit e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kullimit.

Vizioni

Duam të jemi shembull i shoqërisë së suksesshme që ofron shërbime komunale në përputhje me standardet më të larta të cilësisë, duke arritur kënaqësinë e përdoruesve, punonjësve dhe komunitetit të gjerë dhe që përmirëson vazhdimisht proceset e punës dhe prezanton risi në veprimtari, duke integruar çështjen e mbrojtjes së mjedisit në të gjitha proceset e punës.

1.03. Qellimet e Strategjisë operative të zhvillimit

Për të arritur qëllimet e saj strategjike, Shoqëria ka planifikuar një sërë aktivitete, të cilat u kombinuan në programet/projektet që do të zbatohen në vitin e ardhshëm.

Qellimet strategjike të Shoqërisë për vitin që vjen janë:

- intensifikimi i riparimit të defekteve si dhe menaxhimi më i mirë i sistemit, përmirësimi dhe arritja e nivelit të furnizimit të rregullt me ujë,
- ruajtja e korrektësisë kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm,
- puna për përmirësimin e kushteve financiare të veprimtarisë,
- rehabilitimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- të vazhdojë të punojë për reduktimin e humbjeve në rrjetin e ujësjellësit,
- të përmirësojë kushtet e furnizimit me ujë duke rritur funksionalitetin e tij duke rehabilituar rrjetin ekzistues, pajisjen e tij me pajisje matëse dhe rregulluese, si dhe blerjen e nevojshme të agregateve të pompave zëvendësuese dhe pajisjeve të tjera, si dhe mjeteve të punës;
- të përmirësojnë më tej sistemin e cilësisë sipas standardeve ISO 9001 dhe 17025 dhe 17020,
- të sigurojë funksionimin (mirëmbajtjen dhe zhvillimin) e sistemit të informacionit të Shoqërisë.

Qellimet themelore operative të Shoqërisë janë: - të sigurojë korrektësinë e agregateve të pompave të instaluara dhe pajisjeve shoqëruese për nevojat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit,

- duke rishpërndarë sasi të disponueshme të ujit, të sigurojë furnizimin më të rregullt me ujë për të gjithë konsumatorët,
- të kryejë numrin e nevojshëm të kontrolleve për korrektësinë kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm,
- të kryejë numrin e nevojshëm të ndërhyrjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve për të ruajtur funksionalitetin e tij,
- të sigurojë korrektësinë e matësve të ujit në përputhje me rregulloret ligjore,
- kryerja e pagesave për shërbimet,
- lidhja e konsumatorëve të rinj në përputhje me nevojat e sistemit, bazuar në pëlqimin dhe dokumentacionin e projektit të drejtuesit të sistemit,
- të kryejë ndërtimin e rrjetit të ri ose rikonstrukcionin e rrjetit ekzistues të ujësjellës kanalizimeve me kërkesë të klientëve dhe në përputhje me kapacitetet e disponueshme të Shoqërisë për këto detyra;
- të kujdeset që të gjithë konsumatorët të jenë të lidhur ligjërisht me sistemin e ujësjellësit dhe kullimit të ujërave të zeza,
- të përmirësojë dhe zhvillojë sistemin e informacionit të Shoqërisë.
- Mbajtja dhe përmirësimi i sistemeve të menaxhimit;
- Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore.

1.04. Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e shoqërisë për vitin 2024

Korniza juridike në bazë të së cilës funksionon DOO "Vodovod i kanalizacija / SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi - Tuz" bazohet në parimet dhe kushtet e përfshira në ligje, akte nënligjore dhe vendime, përkatësisht:

Ligji për veprimtaritë komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" nr. 55/16, 074/16, 002/18, 066/19 dhe 140/22);

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/2018, 34/2019 dhe 38/2020);

Ligji për Shoqëritë Tregtare ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 65/2020);

Ligji i Metrologjisë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 79/08 dhe 40/11);

Ligji për Mbrojtjen e Personave dhe Pronës ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 43/18);

Ligji i Punës ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", numër 32/13, 75/14,75,13/17,113/17,95/18

Ligji për veprimtaritë komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 55/16, 074/16 dhe 002/18);

Ligji për Ujërat ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 027/10, 073/10, 032/11, 047/11, 048/15, , 055/16, 002/17, 080/17 dhe 084/18);

Ligji për Prokurimin Publik ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", numër 74/19, 23/03 dhe 23/11);

Ligji për sigurimin pensional dhe të invalidëve ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi, numër 010/15,044/15,042/16,055/16,080/20;)

Ligji për Kontabilitetin ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", numër 66/19 dhe 145/21)

Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", numër 053/16,001/17,050/17,046/19,073/19,080/20,008/21,=59/21;)

Ligji për sigurimin e ujit të shëndetshëm për përdorim njerëzor ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 80/17;)

Ligji për Planifikim dhe Ndërtim ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" Nr. 064/17,044/18,063/18,011/19,082/20;)

Ligji për pronën shtetërore ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 21/09, 40/11;)

Ligji për mbeturinat komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", numër 064/11,039/16;)

Shoqëria zbaton edhe rregullore të tjera në fushën e kontabilitetit (Standardet Ndërkombëtare - MSHP, të drejtat e marrëdhënieve të punës, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme në Shoqëri, si dhe udhëzimet dhe instruksione të themeluesit të akteve të brendshme, më të rëndësishmet janë:

Statuti i DOO "Vodovod i kanalizacija/ SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz numër 15/21 Od 01.12.2021.

Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës 02.21 prej më 21.02.21

Rregullore për kontabilitetin dhe politikat kontabël.

Kontrata kolektive DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz

Vendim për themelimin e DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz.

Rregullore për politikat kontabël të DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz

Rregullore për mënyrën, afatet dhe afatet e inventarizimit të pasurisë dhe detyrimin për barazimin e bilancit sipas librave afarist me gjendjen sipas inventarit të .DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz

Vendimet për furnizimin me ujë në zonën e Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi, dispozitat komunale nr. 046/21)

Rregullave për cilësinë dhe shtrirjen minimale të punës për kryerjen e veprimtarive të rregulluara komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" Nr. 058/19 datë 18.10.2019).

Shoqëria zbaton edhe rregullore të tjera në fushën e: kontabilitetit (standardet SNK), marrëdhëniet e punës, aktet e brendshme dhe rregulloret e Shoqërisë.

Shoqëria është themeluar si një anëtar i vetëm, ndërsa themelues i shoqërisë është Kuvendi i Komunës së Tuzit.

Kapitali themelor i Shoqërisë përbëhet nga kapitali bazë i themeluesit, DOO "Vodovod i kanalizacija/SH.P.K Ujësjiellësi dhe kanalizimi" Tuz, d.m.th., asetet e Shoqërisë, pasuria e luajtshme dhe paratë e gatshme.

1.05. Veprimtaritë themelore dhe qellimet e Shoqërisë për vitin 2024

DOO „ Vodovod i kanalizacija/ SHPK Ujësjiellësi dhe kanalizimi” Tuz, është themeluar me Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar DOO“Vodovod i kanalizacija/ SHPK Ujësjiellësi dhe kanalizimi”Tuz, („Fl. Zyrtare e MZ – dispozitat komnale“,nr.040/21 më 03.12.2021).

Veprimtaritë e Shoqërisë janë përcaktuar me aktin e themelimit dhe me statut dhe ajo kryen këto veprimtari komunale me rëndësi publike:

- Furnizimi publik me ujë
- Menaxhimi i ujërave atmosferike

Aktivitetet nga paragrafi paraparak janë aktivitete me interes publik.

Shoqëria mund të kryejë aktivitete shtesë:

- Ndërtimi i rrjetit të ujësjiellës kanalizimeve
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjiellësit dhe kanalizimeve

Burimet e financimit për shërbimet me interes publik:

- Çmimi i shërbimeve komunale ose produktit komunal
- Buxheti i vetëqeverisjes lokale
- Burime të tjera në përputhje me ligjin

1.06. Ekipi drejtues dhe organizimi i Shoqërisë

Bordi i drejtorëve të Shoqërisë është emëruar në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit, të mbajtur më 24 dhjetor 2021, me mandat katërveçar, ndryshime janë bërë për shkak të dorëheqjes së dy anëtarëve. Vendimi i Regjistrimit nr 5-1000519/005 dana 28.08.2023.

Organet e Shoqërisë:

- **Themelues** - Komuna Tuzi është organi që miraton akte, jep miratime, shqyrton raportet, emëron dhe shkarkon anëtarët e bordit, merr vendime për ndryshimin e formës së funksionimit, vendimin për emrin e veprimtarisë, jep miratimin për çmimin e shërbimeve dhe detyra të tjera të përcaktuara me Statut.

- **Bordi drejtues** (si organ drejtues), i cili përcakton politikën e veprimtarisë, miraton akte të përgjithshme, miraton programe dhe raporte, përcakton listën e çmimeve të shërbimeve dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me rregulloret përkatëse. Ky organ ka 5 (pesë) anëtarë.

- Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë - Thirrja e re e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë me mandat 4 vjeçar është emëruar në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit, (si organ qeverisës), i cili organizon dhe menaxhon veprimtarinë e Shoqërisë, përfaqëson Shoqërinë, përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Shoqërisë, zbaton vendimet e Bordit të Drejtorëve dhe vendos për çështje të tjera që lidhen me punën dhe funksionimin e vazhdueshëm të Shoqërisë. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve me pëlqimin e Themeluesit në bazë të konkursit publik.

Meqenëse aktet e themelimit të Shoqërisë parashikojnë detyrimin për vlerësimin e pasurisë së Shoqërisë, në periudhën e ardhshme do të bëhet regjistrimi i pasurisë, në bashkëpunim me organet kompetente të komunës së Tuzit, Administratën e Pasurive të Paluajtshme dhe autoritete të tjera, për të kryer një regjistrim të saktë dhe të plotë të pasurisë në bazë të pronësisë dhe përdorimit. Në këtë drejtim, duhet theksuar se me Propozimin e Ligjit për Veprimtaritë Komunale përcakton se infrastruktura komunale, e nevojshme për kryerjen e veprimtarive komunale, është një pasuri lokale në pronësi shtetërore në dispozicion të njësisë së vetëqeverisjes lokale, për të

cilat duhet të regjistrohen të drejtat pronësore; ndërsa operatori i shërbimeve komunale përdor infrastrukturën e shërbimeve. Në funksion të kësaj, asetet e Shoqërisë që përdoren për kryerjen e aktiviteteve publike të furnizimit me ujë (burimet në tokë, stacionet e pompimit, rezervuarët dhe tubacionet), si dhe për kryerjen e aktiviteteve të largimit dhe trajtimit të ujërave të zeza (rrjeti i ujërave të zeza, kolektorë dhe pajisje për trajtimin e ujërave të zeza), është një infrastrukturë komunale dhe e njëjta nuk mund të jetë në pronësi të Shoqërisë, por në pronësi të shtetit, gjegjësisht komunës, dhe Shoqëria mund të ketë të drejtën ta menaxhojë, përdorë dhe mirëmbajë atë dhe të regjistrohet si të tilla pranë organit kompetent.

1.07. Plani i punës i Bordit të drejtorëve

Aktiviteti i përhershëm dhe vëmendja e veçantë e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2024 do të drejtohet në dy segmente thelbësore: fushën e punës së rregullt dhe realizimin e investimeve të planifikuara. Bordi i Drejtorëve gjithashtu do të monitorojë intensivisht punën e Shoqërisë, do të hartojë dhe udhëheqë një politikë biznesi në drejtim të zhvillimit të saj, duke zbutur efektet negative të krizës ekonomike, tejkalimin e problemeve në marrëdhëniet e biznesit me përdoruesit e shërbimeve dhe eliminimin e pengesave të tjera që pengojnë operacionet e Shoqërisë. Do të iniciojë ripërcaktimin e marrëdhënieve të biznesit në ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, me synimin për të siguruar furnizim të vazhdueshëm me ujë. Gjithashtu, do të rishikojë politikën e çmimeve dhe do të vendosë çmime të reja për furnizime periodike të ujit, si dhe do të marrë vendimet e duhura për të mbledhur borxhin për ujin e shpërndarë. Me Vendimet për përdorimin e fondeve, shfrytëzimin e pasurisë, shpërndarjes së fitimeve dhe mbulimin e humbjeve do të synohet sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm në kushtet e krizës ekonomike globale. Kostot e Shoqërisë do të vazhdojnë të reduktohen dhe do të vendosen masa të reja në drejtim të veprimtarisë racionale, kursimeve dhe përmirësimit të likuiditetit aktual. Do të vendoset edhe mbi investimin e planifikuar dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e Shoqërisë. Do të merren shqyrtohen informacionet e Drejtorit Ekzekutiv mbi veprimtarinë e shoqërisë në mes të seancave të Bordit të Drejtorëve, Raportit të Punës dhe raportit financiar (Ilogarisë përfundimtare) për vitin aktual. Do të miratohen planet e Shoqërisë për vitin e ardhshëm (Plani i Punës, Plani i Prokurimit Publik, Plani Financiar etj.), aktet e përgjithshme dhe të tjera me rëndësi për veprimtarinë dhe punonjësit. Propozimet për dokumentacionin kontraktual do të shqyrtohen dhe do të merren vendime lidhur me to. Ajo do të marrë edhe vendime të tjera investimi, në përputhje me nevojat e procesit të punës dhe detyrimet e përcaktuara në aktet e themelimit, zgjidhjen e çështjeve në fushën e marrëdhënieve të punës, kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe formimin profesional të punonjësve. Marrëdhëniet juridike të punës me punonjësit përfshijnë:

zgjidhjen e çështjeve të punës dhe juridike të punonjësve (kërkesa, iniciativa, paga, përfitime, udhëtime pune, etj.).

Bordi i drejtorëve do të diskutojë dhe do të vendosë për çështje të tjera të rëndësishme brenda fushëveprimit të tij.

1.08. Bashkëpunimi me organet dhe shërbimet publike që janë me ndikim në realizimin e Programit

Me qëllim të kryerjes efikase të detyrave programore dhe zhvillimore të kësaj Shoqërie, është e domosdoshme që në mënyrë strategjike të përmirësohet bashkëpunimi me të gjitha organet e vetëqeverisjes lokale dhe organet tjera kompetente, siç janë:


- Sekretariati për zhvillim dhe projekte (organi i mbikqyrjes i kësaj Shoqërie),
- Agjencioni rregullues për energjetikë (trupi rregullues për veprimtaritë e rregulluara komunale),
- Sekretariati për komunikacion,
- Drejtorja e policisë (asistenca e zyrtarëve policor me rastin e arkëtimit dhe zbatimit të masave ndaj konsumatorëve – debitorëve me qëllim të plotësimit të obligimeve të tyre, si dhe procedimit në bazë të kallëzimeve penale),
- Policia komunale (ofrimi i shërbimeve me kërkesë të Shoqërisë për ndërhyrje të caktuara ndaj konsumatorëve),
- Instituti për shëndetin publik (përcjellja dhe zbatimi i të gjitha masave të normuara mbi rregullsinë e ujit të pijshëm nga ana higjienike),

- Elektroekonomia e MZ, Posta e MZ dhe Telekom i MZ (pagesa e një pjese të borxhit për energjinë elektrike për ujësjellësat rural; dorëzimi më efikas i llogarive konsumatorëve; bashkëpunimi përmes aktiviteteve të planifikuara të leximit të ujëmatësve nga distanca),
- Enti për metrologji (koordinimi i punës sa i përket çështjes së përgatitjes dhe kalibrimit).

1.09. Skema organizative e Shoqërisë

Me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin me përshkrim të punës në DOO "Vodovod i kanalizacija / SH.P.K Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, është formuar njësi organizative vijuese.

Tabela 1.



1.10. Përmirësimi organizativ dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Spektori për punët teknike

- Rishpërndarja e punëtorëve nga struktura ekzistuese e punëtorëve për efikasitet më të mirë në veprimtari në vitin 2024

Spektori për çështje juridike dhe të përgjithshme

- Hartimi i një plani për edukimin dhe trajnimin e punëtorëve në vitin 2024 në të gjithë sektorët.
- Miratimi i Rregullores së re për punën dhe organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në vitin 2024

1.11. Numri dhe struktura e të punësuarve

Sipas Rregullores në fuqi mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në DOO "Vodovod i

kanalizacija/ SH.P.K Ujësjetllësi dhe kanalizimi” Tuz, jnaë sistematizuar në total 35 punëtorë, prej të cilëve 22 me kohë të pacaktuar ndërsa 17 me kohë të caktuar. Struktura sipas sektorëve është si në vijim:

Drejtori ekzekutiv.....PLP- 1
 Ndihmës-drejtoriPLP - 1

BURIMET NJERËZORE Tabela nr. 2 Struktura kualifikuese e Shoqërisë

	SEKTORI/SHËRBIMI	EKIPI	Numri i të punësuarve	KPL	SHL	KPM	KU	GJK	PK
1	DREJTORIA	2							
2	SEKTORI TEKNIK			4	0	20	0	0	4
3	SEKTORI PËR PUNËT JURIDIKE DHE EKONOMIKE			5	0	7	0	0	1
	Gjithsejt		39						

1.12. Paga mesatare

Pagat mesatare me pjesën fillestare të ardhurave që përfshijnë kompensimet për regres për pushim vjetor dhe shpenzimet e ushqimit gjatë punës, e të cilat sipas dispozitave ligjore janë transferuar në pjesën fillestare të pagës, sipas kualifikimit profesional janë si vijon:

Tabela 3.

Kualifikimi profesiona	Paga mesatare neto
KPL	620.00 €
KPM	465.00€
KU	450.00€
PK	450.00€

Paga mesatare me pjesën fillestare që përfshinë kompensimin për regres për pushim vjetor dhe shpenzimet e ushqimit gjatë punës, e të cilat sipas dispozitave ligjore janë transferuar në pjesën fillestare të pagës është 548.57€. Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç’gjë e tregon edhe indikatorin e kualitetit të shërbimeve që është në nivelin e normuar nga standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe struktura kualifikuese dhe sipas moshës, e kjo më së miri dëshmohet me faktin se numri i të punësuarve të cilët kryejnë punët nga lëmia e veprimtarisë themelore përbën 56,87% të numrit total.

1.13. Struktura e moshës e të punësuarve

Tabela 4

Numri rëndor	Përshkrimi	Numri i të punësuarve	Numri i të punësuarve në vitin 2022	Numri i të punësuarve në vitin 2023	Total
1	Deri 30 vjeç	13			
2	Prej 30-40 vjeç	19			
3	Prej 40-50 vjeç	9			
4	Prej 50-60 vjeç	0			
5	Mbi 60 vjeç	2			
	Ukupno		39	4	43

II . STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQËRISË

Organizimi i Shoqërisë është i rregulluar me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi“ Tuz numër 02/21 e vitit 2021. Duke u bazuar në Rregulloren e SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi“ Tuz, janë sistemuar 68 vende të punës, ku janë llogaritur edhe vendet e anëtarëve të Bordit të drejtorëve.

Për kryerjen e veprimtarisë ligjore SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi“ Tuz, ka vendosur skemën adekuate organizative të cilën e përbëjnë, dy sektorë:

-Sektori teknik

-Sektorii për punët ekonomike dhe juridike

Shoqëria për kryerjen e veprimtarive të veta ka konceptuar strukturën organizative funksionale që mundëson përdorimin efikas të gjitha resurseve të disponueshme dhe shfrytëzimin racional të njohurive dhe aftësive të punësuarve.

Për kryerjen e veprimtarisë në SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjiellësi dhe kanalizimi“ Tuz janë organizuar sektorët si njësi themelore organizative. Secili sektor ka njësitë organizative në përbërjen e vetë dhe atë: shërbimet, departamentet. Në atë drejtim çdo njësi organizative i ka detyrimet e përcaktuara qartë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjiellësit dhe kanalizimit Tuz.

Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç’gjë e tregon edhe indikatorin e kualitetit të shërbimeve që është në nivelin e normuar nga standardet ndërkombëtare.

2.01. Pajisja teknike dhe materiale e Shoqërisë

Shoqëria nuk disponon me Ndërtesë të Drejtorisë në Tuz. Në mënyrë që sistemi të funksionojë në tërësi, është e domosdoshme që në periudhën vijuese të punohet në ndërtimin, jo vetëm të Ndërtesës së Drejtorisë, por edhe të ndërtesës me përmbajtje administrativo-operative, ku do të vendoseshin dhoma e kalibrimit, laboratorin për testimin e kualitetit të ujit të pijshëm, mirëmbajtja elektro-mekanike, punëtorja për mirëmbajtjen e automjeteve, hapësirë depoje, qendra për menaxhim nga distanca me sistemin e ujësjiellësit – qendra dispeçer përmes të cilës do të kryhej optimizimi i shpenzimit dhe kontrolli i sistemit të ujësjiellësit.

Automjete dhe mekanizim,

Nr.r Lloji i automjetit

1. Furgon
2. Veturë

Shoqëria disponon me :

- 2
- 1

2.02. Swot analiza e Shoqërisë

Analiza SWOT është bërë me qëllim të marrjes së një pasqyre përkatëse të situatës brenda Shoqërisë, si dhe në mjedisin në të cilin ndodhet dhe operon. Kjo analizë i identifikoi të gjithë pikat e forta dhe të dobëta të brendshme, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që vijnë nga jashtë, me qëllim që pikat e forta dhe mundësitë të përdoren në maksimum, ndërsa dobësitë të eliminohen, shmangen ose minimizohen si

kërcënime. Për realizimin dhe arritjen e analizës SWOT sa më të besueshme dhe cilësore, ajo është realizuar në atë mënyrë që në të kanë marrë pjesë të gjitha njësitë organizative dhe një numër i madh i menaxherëve, të gjitha njësitë organizative dhe të gjitha proceset e biznesit, të gjitha palët e interesuara, të jashtme me ndikim, dhe mbi të gjitha u analizuan tregu dhe konkurrenca.

Analiza e avantazheve u krye me qëllim të përcaktimit të mundësive dhe përcaktimit të mënyrave për t'i arritur ato.

Analiza e dobësisë është kryer me qëllim përcaktimin e ndikimit real të saj dhe përcaktimin e masave për eliminimin e saj. Analiza e rasteve dhe mundësive u krye me synimin për të drejtuar aktivitetet e Shoqërisë në kombinim me aftësitë tona për të arritur qëllimet e përcaktuara. Analiza e kërcënimit është kryer me qëllim të përcaktimit të strategjisë dhe veprimeve për të shmangur kërcënimet e mundshme ose për të zbutur ndikimin e tyre.

Nga të gjitha pikat e forta, dobësitë, kërcënimet dhe mundësitë e identifikuar, janë veçuar këto që kanë ndikimin më të madh në Shoqëri, dhe si të tilla ato mund të përdoren, përkatësisht, duhet të eliminohen me qëllim që të mos rrezikohen operacionet e Shoqërisë.

Rezultati i analizës është një strategji, e bazuar në avantazhet dhe mundësitë e vendosura, dhe veprimet e përcaktuara që kompania duhet të ndërmarrë për të arritur qëllimet strategjike. Në të njëjtën kohë analiza SWOT e kryer korrigjon qëllimet strategjike fillestare, në mënyrë që ato të jenë realiste dhe të arritshme. Analiza evidentoi anët e mira si dhe dobësitë e vetë sistemit të Shoqërisë dhe mjedisit të saj të brendshëm, si dhe kërcënimet dhe mundësitë në mjedisin e jashtëm, të cilat **shoqëria nuk mund të ndikojë në masën më të madhe.**

Dobre strane privrednog Društva su da je:

- Važan privredni subjekat u funkcionisanju zajednice;
- Kvalitet vode na izvorištima zadovoljava standarde;
- Zadovoljavajuća stopa priključenosti na vodovodnu mrežu;
- Relativno dobra opremljenost Društva
- Dobra saradnja sa lokalnom samoupravom;

Prijetnje u poslovanju Društva su:

- Nedovoljna finansijska sredstva za značajnija ulaganja uInfrastrukturu;
- Stalno povećanje cijena inputa (gorivo, materijala itd.);
- Tendencija smanjenja fakturisanje realizacije;

- Nerazvijena svijest o značaju vode i potrebi njene zaštite
- Poremećeni prioriteti korisnika prilikom plaćanja obaveza.

Evidentne slabosti Društva su:

- Nedovoljna izgrađenost kanalizacionog sistema;
- Značajan stepen neprihodovane vode;
- Bespravno priključenje na vodovodni sistem;
- Nedovoljna finansijska sredstva za značajnija ulaganja.

2.03. Analiza e veprimtarisë për vitin 2023

Gjatë analizës së rezultateve të përlogaritura të veprimtarisë në vitin 2023, arritëm te parametrat bazë të veprimtarisë, të cilët përfaqësojnë supozimet e planifikimit për projeksionin e të gjithë veprimtarisë në vitin 2024.

2.04. Vëllimi i vlerësuar fizik i aktiviteteve në vitin 2024

Plani për vëllimin fizik të prodhimit të ujit është bërë në bazë të sasive të prodhuara në vitin 2023 dhe kapaciteteve të instaluara të burimeve.

Shoqëria, furnizon shumicën e zonave të komunës së Tuzit, me tre burime.

Vlerësohet se vëllimi fizik i ujit për vitin 2023 do të realizohet me 105.7% krahasuar me sasitë e planifikuara në Programin e Veprimtarisë nga viti 2022.

Plani për vëllimin fizik të shitjeve të ujit dhe kullimit të ujërave të zeza për të gjitha kategoritë e konsumit është bërë në bazë të vëllimit të arritur të shitjeve në vitin 2023, kërkesës së supozuar për produktin dhe shërbimin e specifikuar dhe rritjen e planifikuar të numrit të përdoruesve për kategori të caktuara konsumatorësh.

Humbjet që duhen raportuar në këtë moment janë të pamundura të përcaktohen për arsye se nuk disponojmë me të dhënat e ujit të pompuar pasi kjo është në kompetencë të Ujësjesit të Podgoricës, në përputhje me Vendimin mbi rregullimin e përkohshëm të mardhënieve mes Kryeqytetit dhe Komunës së Tuzit deri në ndarjen përfundimtare të pasurisë të krijimit të kushteve për punë të Komunës së Tuzit, prej më 23.12.2021.

Humbjet shprehen në përqindje dhe sipas një vlerësimi të lirë janë mbi 45% të ujit të lëshuar.

Humbjet përfshijnë:

a) humbjet fizike në rrjet

b) humbjet administrative

- Humbjet fizike në rrjet janë ato humbje që vijnë si rezultat i rrjedhjes së ujit në rrjet për shkak të lidhjeve me defekt, plasjes së tubave të konsumit gjatë shpëlarjes së tubave dhe konsumit të hidrantëve të rrugës.

- Humbjet administrative përbëjnë të gjithë konsumin e paregjistruar, pavarësisht nëse është i ligjshëm (çezma publike) apo i paligjshëm, si p.sh. lidhjet ilegale.

Për të pasur të dhëna më të besueshme për humbjet, është e pamundur deri në shpërndarjen përfundimtare të pasurisë me Kryeqytetin dhe marrjen e të gjitha përgjegjësive nga Shoqëria. Vetëm atëherë do të merren masa për të reduktuar humbjet.

2.05. Realizimi i programit të punës për dhjetë muajt e vitit 2023

Shërbimi për Zhvillim dhe Investime në raportin e tij theksoi se në periudhën e kaluar për vitin 2023 janë pranuar 226 kërkesa, shkresa dhe ankesa, ndërsa për kushte teknike janë pranuar 161 pëlqime. Një analizë e detajuar do të përpunohet në fund të vitit dhe të dhënat do të dorëzohen në një raport që kërkohet për përgatitjen e operacioneve të Shoqërisë për vitin 2023. Gjatë vitit të kaluar, referentet e shërbimit të zbulimit të humbjeve gjetën dhe lokalizuan 522 defekte në rrjet. Të njëjtat janë gjetur në profile të ndryshme tubash.

2.06. Aktivitetet programore (sektori teknik) në vitin 2024

Veprimtaritë që kanë prioritet absolut në përputhje me misionin e shoqërisë dhe detyrimin për kryerjen e shërbimeve komunale i referohen dërgimit të sasive të mjaftueshme të ujit higjenikisht korrekt për të gjithë përdoruesit e sistemit të ujësjellësit. Në përputhje me këtë, është e nevojshme që të gjitha pjesët e këtyre sistemeve të mbahen në gjendje të përhershme korrekte dhe në funksion të plotë, gjë që mund të realizohet me sigurimin në kohë të sasisë dhe rezervave të nevojshme të materialeve më cilësore, shërbime nga furnitorë individualë, trajnime dhe pajisjet e punëtorëve, lëvizshmëria dhe organizimi i mirë i punës.

Për të përmirësuar më tej sistemin e furnizimit me ujë, është e nevojshme të përcaktohen prioritetet e mëposhtme:

Tabela 5. Prioritetet e planifikuara të sektorit teknik

Nr.r OPERATIV	QËLLIMI	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA
1	Mirëmbajtja efikase dhe e rregullt e rrjetit të ujësjellësit me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike	Zbulimi me kohë dhe zvogëlimi i humbjeve teknike dhe të ashtuquajturave humbje në rrjet; Riparimi i të gjitha defekteve në rrjetin e ujësjellësit Ndrimi i disa akseve të rrjetit të ujësjellësit në kuadër të punimeve urgjente; Inspektimi i rregullt i të gjitha nyjeve në pjesën e tubacioneve magjistrale, riparimi i tubacionit dhe ndrimi i të gjitha mbyllëseve dhe valvulave të ajrit të dëmtuara; Punimi i lidhjeve të reja në rrjetin e ujësjellësit dhe zhvendosja e atyre ekzistuese në bazë të kërkesave të pranuar të konsumatorëve; Zhvendosja e ujëmatësve në bazë të kërkesave të pranuar të konsumatorëve; Zbatimi i konsumimit të planifikuar të ujit në disa zona në rastin e zvogëlimit të prurjeve të burimeve gjatë periudhës së verës; Mirëmbajtja e instalimeve të ujësjellësit në çezmet publike në gjendje të rregullt pune.

2	<p>Mirëmbajtja e objekteve në rrjetin e ujësjellësit në gjendje funksionale dhe modernizimi i tyre</p>	<p>Pastrimi i pusetave të ujësjellësit dhe ndrrimi i pjesëve të vjetëruara të armaturës dhe pjesëve tjera; Inspektimi dhe riparimet e domosdoshme në të gjithë hidrantët aktiv në rrjetin e ujësjellësit; Pastrimi i rregulltë dhe mirëmbajtja e rubinetave të qytetit në gjendje funksionale; Riparimi i sipërfaqeve të betonit dhe të asfaltit të dëmtuara me rastin e kryerjes së punimeve në mirëmbajtjen e infrastrukturës hidroteknike.</p>
3	<p>Përcjellja e cilësisë së ujit</p>	<p>Marrja dhe testimi i rregullt i ujit i vëllimit themelor (analiza A), 24 mostra katër herë në muaj; Testimi periodik (analiza B) i kualitetit të ujit, 12 mostra dy herë në vit; Testimi periodik (analiza C) i kualitetit të ujit, 6 mostra në vit; Kontrolli i përditshëm i përqendrimit të klorit rezidual në burimet dhe disa vende të rrjedhjes në vendbanime; Ekzaminimi i jashtëzakonshëm i ujit në rastet e reshjeve të dendura dhe paraqitjes së anomalive tjera, si dhe me rastin e ndrrimit të tubave, riparimit të defekteve, ndërtimit të pjesëve të reja të tubacionit.</p>
4	<p>Mirëmbajtja e rregulltë mekanizacionit dhe automjeteve</p>	<p>Prokurimi i eskavatorit rrotullues; Prokurimi i automjetit kamion hale me vinç Mirëmbajtja e të gjitha automjeteve në gjendje të rregullt teknike me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve operative.</p>

DOO Vodovod I kanalizacija / SH.P.K Ujësjellësi dhe kanalizimi“- Tuz, në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale përpiqet për zhvillim të balancuar të gjitha bashkësive lokale, kur bëhet fjalë për furnizimin publik me ujë, si një ndër kushtet më të rëndësishme për rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve.

2.07. Sektori për punët ekonomike dhe juridike

Një ndër detyrat më të rëndësishme të këtij sektori është evidentimi i saktë i përdoruesve të shërbimeve komunale, faturimi i shërbimeve sipas të gjitha kategorive të konsumatorëve (amvisëritë dhe personat juridik) dhe arkëtimi sa më efikas i llogarive. Zhvillimi cilësor dhe eficient i sistemit informativ është përbërës shumë i rëndësishëm i çdo procesit të punës sepse mundëson mbështetje sistimore dhe aplikative të gjitha njësive organizative të Shoqërisë. Me mbajtjen e evidences kontabiliste në bazë të rregullave të normuara dhe në pajtim me standardet relevante të kontabilitetit MRS, Ligjin mbi kontabilitet dhe auditim kontribohet pasqyrimin objektiv të veprimtarisë financiare dhe rezultateve të Shoqërisë, e me vetë këtë kontribohet për ruajtjen e likuiditetit.

Sektori për çështjet juridike përfshinë edhe punët administrative-juridike nga lëmia e punës së Shoqërisë, mbrojtjen e pronës dhe objekteve të Shoqërisë dhe sigurimin e mjeteve themelore dhe inventarit të domosdoshëm për veprimtarinë. Udhëheqja e rregullt e politikës së biznesit nënkupton kryerjen e veprimtarisë në pajtim me kornizën legjislative që është e normuar për veprimtarinë që kryen kjo Shoqëri. Kualifikimet menaxhuese dhe profesionale të punësuarve, atmosfera pozitive e punës dhe siguria në punë janë elementet kyçe për organizimin adekuat të veprimtarisë dhe arritjes së rezultateve pozitive, e me vetë këtë ngritja e kapaciteteve kadrovike dhe avansimi i çështjeve nga fusha e punës janë qëllimet kryesore të këtij sektori.

Në vitin 2024 theks i veçantë do të vihet në avansimin e çështjeve nga fusha e punës, përditësimin e evidencës amë, menaxhimin efikas me resurset njerëzore, ngritjen e kapaciteteve kadrovike, përmirësimin e kushteve të punës për të punësuarit.

Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç'gjë e tregon edhe indikatorin e kualitetit të shërbimeve. Gjithashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe struktura kualifikuese dhe sipas moshës, e kjo më së miri dëshmohet me faktin se numri i të punësuarve të cilët kryejnë punët nga lëmia e veprimtarisë themelore përbën 70,87% të numrit total të punësuarve.

2.08. Aktivitetet programore (Shërbimi për çështjet juridike) në vitin 2024

Prioritetet e planifikuara të sektorit për punët ekonomike dhe juridike;

Tabela 6.

Nr.r	QËLLIMI OPERATIV	AKTIVITETET PLANIFIKUARA	E
1	Avansimi i çështjeve nga fusha e punës	Përgatitja me kohë e akteve individuale për të punësuarit; Zvogëlimi i kohës mesatare të nevojshme për përgatitjen e akteve; Krijimi i masave për avansimin e organizimit të punës dhe kryerjes së punëve; Procedimi me kohë sipas kërkesave të punësuarve; Korrespondenca e vazhdueshme me Entin për punësim, Fondin e SPI, Administratën tatimore, Administratën e Kuadrove.	
2	Mbajtja efiçente dhe e përditësuar e evidencës amë	Përditësimi i rregullt i bazës së të dhënave; Avansimi i sistemit informativ në kuptimin e përmirësimit të programit për evidencën kadrovike; Përgatitja e dosjes personale elektronike të të punësuarit; Përgatitja e planit vjetor të pushimeve vjetore dhe përcjellja e realizimit të tij; Mbajtja e rregullt dhe e saktë e evidencës mbi orarin e punës të punësuarve; Zvogëlimi i gabimeve të mundshme në mbajtjen e evidencës amë.	
3	Puna efiçente në lëminë e punëve administrativo-juridike në punën e Bordit të drejtorëve	Organizimi i seancave të Bordit të drejtorëve; Përgatitja e materialit për seancë dhe dorëzimi i tij me kohë; Mbajtja e procesverbalit detajor nga seanca; Përgatitja e Vendimeve dhe shënimeve zyrtare nga seancat.	

4	<p>Mbajtja adekuate dhe e përditësuar e evidencës të materialit regjistruar</p>	<p>Mbajtja e evidencës në pajtim me Rregulloren e veprimtarisë në zyre dhe veprimtarinë arkivore; Kryerjen e rregullt të punëve të përzgjedhjes së materialit arkivor dhe ekskretimi i materialit të pavlefshëm regjistruar; Trajnimi shtesë i të punësuarve në këtë pjesë të punëve.</p>
